



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
GJIROKASTËR

PROCEDURAT E KËRKESAVE/ANKESAVE PRANË GJYKATËS

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre që lidhet me kërkesat e paraqitura nga palët në gjykim apo publiku i gjerë, kryetari dhe kancelari i gjykatës ndjekin të gjithë procedurën e parashikuar nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe aktet ligjore të nxjerra për zbatim për këtë qëllim nga Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Publiku/palët ndërgjyqëse në çdo kohë mund të marrin informacion zyrtar në disa mënyra nëpërmjet:

1. Faqes zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër www.gjykata.gov.al e cila pasqyron në rubrikat e saj informacione të ndryshme që lidhen me çështjes gjyqësore (civile dhe penale), me të dhënat statistikore të gjykatës, vendimet përfundimtare të gjykatës, kalendarin e seancave gjyqësore (datat e gjykimeve), listën e shortimit elektronik të çështjeve gjyqësore, vendimet e Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, njoftime të ndryshme gjyqësore dhe jo gjyqësore, njoftime lidhur me vendet vakante në procedurat e rekrutimit të nëpunësve civil gjyqësore pranë kësaj gjykate etj;
2. Zyrës së Marrëdhënies me Publikun, aksesit i ofrohen publikut në ambientet e gjykatës lidhur me informacionet e ndryshme që jepen nga nëpunësi i gjykatës pranë Zyrës së Marrëdhënies me Publikun gjatë orarit zyrtar të punës 08:00-16:00;
3. Stendat e afishimit të listave të gjykimeve dhe shorteve, aksesueshmëri gjatë edhe pas orarit zyrtar të punës së gjykatës në stendat e afishimeve të vendosura në hyrjen kryesore të kësaj gjykate. Këto lista pasqyrojnë datat dhe orën e gjykimit të çështjeve gjyqësore që shqyrtohen nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër si dhe listat të cilat japin informacion zyrtar lidhur me shortimin elektronik të çështjeve gjyqësore (data/ora e shortit/gjyqtari relator/kategoria e çështjes/emrat e palëve ndërgjyqëse).
4. Email-it zyrtar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër rrethigjirokaster@gjykata.gov.al, adresë në të cilën mund të dërgohen në çdo kohë kërkesa të ndryshme që lidhen me informacione zyrtare dhe transparente lidhur me statusin e çështjeve gjyqësore, datat e planifikimit të gjykimit, kërkesa për shtyrjen e seancave gjyqësore të cilat i dërgohen për vlerësim gjyqtarit relator të çështjes para datës dhe orës së seancës gjyqësore etj.
5. Shërbimit postar, shërbim në të cilin gjykatës i përcillen kërkesa nga qytetarët, palët ndërgjyqëse, gjykatat e tjera, institucionet qendrore dhe vendore etj.

❖ Llojet e kërkesave.

Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit:

- a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik (gjykata), përveç rasteve të veçanta;
- b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe nëse ai parashikon një kosto/tarifë gjyqësore ajo merret nga gjykata në respektim të tarifave të përcaktuara sipas ligjit, Udhëzimit Nr.33, datë 29.12.2014 të Ministrisë së Drejtësisë “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë”.

Kërkesat sipas ligjit të informimit regjistrohen në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve sipas modelit të përcaktuar nga Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistri i kërkesave pasqyron:

1. Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve;
2. Data e regjistrimit të kërkesës;
3. Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi;
4. Data e kthimit të përgjigjes;
5. Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi;
6. Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar;
7. Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik(gjykata).

❖ Afati për marrjen e informacionit.

Autoriteti publik (Gjykata) sipas ligjit nr.119/2014 trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe. Ky afat mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:

- a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;
- b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;
- c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuarit. Ky parashikim ligjor zbatohet edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji.